



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLAnr.90/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Skënder Çoçaj dhe Arsim Hamzaj – anëtar, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.10.2025, merr këtë:

VE N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZLAnr.90/2025, e datës 01.10.2025, parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 01.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se më datë 30 shtator 2025, aktivistet e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, kanë vërejtur banerat/posterët të vendosura në hapësirat/rrugët publike, (pritoret e autobusëve), të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në rrugën “Bulevardi Bill Clinton”, në rrugën “Enver Maloku”, në rrugën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, dhe në rrugën “Robert Doll”, në Prishtinë. Duke shtuar se me këtë veprim ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke kërkuar kështu që ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur disa fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 02.10.2025, të Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës theksojnë se e kundërshtojnë ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, si të pabazuar.

Kanë theksuar se hapësirat ku janë vendosur materialet zgjedhore nuk janë shfrytëzuar në mënyrë të paligjshme, por është në menaxhim dhe përdorim të rregullt nga Kompania

“Selmans Network”, për të cilën kanë lidhur kontratë me Komunën e Prishtinës. Tutje, në përgjigje në ankesë theksohet se LDK nuk ka vendosur banera në mënyrë të drejtpërdrejtë e pa leje, por ka vepruar përmes marrëveshjes së ligjshme të lidhur me Kompaninë “Selmans Network”, si dhe me pëlqimin e marrë nga Komuna e Prishtinës, për vendosjen e materialeve zgjedhore në hapësirat përkatëse. Tutje, kanë shtuar se duke qenë se Kompani Selmans ka pëlqim të posaçëm nga Komuna e Prishtinës, për përdorimin e hapësirave publike për materiale zgjedhore, për 72 hapësira, në të cilat përfshihen edhe subjektet e tjera, vendosja e banerëve nga ana e subjekti politik LDK, është bërë në mënyrë të ligjshme, duke propozuar që të refuzohet ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje si e pabazuar.

Si provë në përgjigje në ankesë e kanë bashkëngjitur kontratën e lidhur me Kompaninë “Selmans Network”, të datës 12 shtator 2025, pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Prishtinës, me numër reference D.Z/2025, e datës 18.09.2025, si dhe pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Prishtinës, me numër reference 07-533/02-140519/25, e datës 15.09.2025, lëshuar për Selmans Network.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa- PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa është e pa bazuar.

- Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, të subjektit politik LVV dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli ka gjetur se në bazë të shkresave të bashkëngjitura në përgjigje në ankesë ga subjekti politik LDK kane vërtetuar faktin se me date 12.09.2-25 kane lidhur kontratën mes subjektit politik LDK dhe Kompanisë “Selmans Network” për shfrytëzimin e hapësirave – pritoret e autobusëve në Prishtinë me mundësi reklamuese për subjektin politik LDK në periudhën prej 12.09.2025 e deri me 12.10.2025, kjo kompani ka marrë Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Prishtinës, 07-533/02-140519/25, e datës 15.09.2025, lëshuar për Selmans Network, si dhe njëkohësisht me date 18.09.2025 LDK kane marrë Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Prishtinës për subjektin politik LDK për shfrytëzimin e hapësirave publike në pritoret e autobusëve të qytetit. Pra vendosja e tyre posterave është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht nën paragrafi 1.2 *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.90/2025 më datë 03.10.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.